



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 144, datë 12.11.2021

PËR

MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË SHESHIT PARA MAUZOLEUMIT TË DËSHMORËVE ME EMRIN “JORGJI ZIU”, NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “11” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 3, të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 475, datë 23.12.2017 “Për miratimin e sistemit të ri të adresave të Bashkisë Durrës” i ndryshuar, si edhe sipas relacionit të Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Sport, Rini, Komunitete Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Emërtimin “Jorgji Ziu” të sheshit para Mauzoleumit të Dëshmorëve sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Sport, Rini, Komunitete Fetare si dhe Ndërmarrja Rruga.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi

U shpall sot me datë 12.11.2021







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 914/prot.
2

Durrës, më 17.11.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.144 datë 12.11.2021 “Për miratimin e emërimit të sheshit para mauzoleumit të dëshmorëve me emrin “Jorgji Ziu”, në territorin e Bashkisë Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ROLAND ASTO
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës